



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 23 dhjetor 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë anëtarët e Komisionit: Rustem Mustafa, Suzana Novoberdaliu, Zafir Berisha, Shkumbin Demaliaj, Zylfi Merxha dhe Lulzim Zeneli.

Munguan: Melihate Termkolli, Eqrem Kryeziu dhe Bojan Stojanovič.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi, Blerina Pula dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të 16. 12. 2009,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë,
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 16. 12. 2009

Procesverbali i 16. 12. 2009 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Kryetari i Komisionit – Tha se është ligj mjaft i rëndësishëm dhe i ftoi të gjithë të jepnin kontributin e tyre me anë të komenteve që ky ligj të jetë sa më i kompletuar. Kemi mbetur vetëm unë si kryetar i Komisionit dhe Eqrem Kryeziu, që nuk kemi qenë referues për ndonjë projektligj. A pajtoheni që këtë javë të vendos se kush do ta marrë këtë projektligj?

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Në lidhje me Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale i njoftoi se është bërë një kërkesë për ta shtyrë afatin për përfundimin e shqyrtimit të këtij projektligji. Ia dha fjalën referueses Suzana Novoberdaliu.

Suzana Novoberdaliu – Kam qenë referuese për këtë projektligj. Siç ju kam treguar, e kemi mbajtur vetëm një dëgjim publik, por e kemi vërejtur se shqyrtimi i Projektligjit nuk ka mundësi të kryhet në afatin e paraparë. Për këtë arsye kemi kërkuar të shtyhet. Në lidhje me këtë projektligj, do të organizohet një punëtori dhe do të ftojmë ekspertë që do japin komentet e tyre.

Kryetari i Komisionit – Tha se punëtorja do të organizohet në pjesën e dytë të janarit, dhe të gjithë anëtarët e Komisionit duhet ta japin kontributin e vet.

Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Policinë, grupi i formuar duhet të fillojë të punojë dhe në fund të janarit ta kemi një raport për zbatimin e këtij ligji. Unë, gjatë kohës që isha në Shqipëri, pashë se ata kishin formuar një komision hetimor për gradimin e Policisë. Ne, asnjë anëtar i Komisionit, nuk e dimë si janë bërë gradimet në Polici dhe për këtë arsye duhet të punojmë, që të dimë si po zhvillohet situata.

Zafir Berisha – Ne kemi pasur në Komision takime dhe raportime nga ana e Policisë, mirëpo mendoj se nuk mund të njoftohemi vetëm nga zyrtarët e lartë. Vetëm desha ta përmend çështjen që të mos marrim të dhëna ose opinione nga zyrtarët e lartë.

Lulzim Zeneli – Mendoj se duhet t'i identifikojmë mekanizmat që janë të involvuar në një mënyrë ose në një tjetër. Nëse i identifikojmë ata mekanizma mund ta bëjmë një agjendë dhe grupi i punës në bazë të saj t'i qaset në praktikë. Duhet të përqendrohemi te stacionet e Policisë dhe gjatë vizitave të mos krijohet përshtypja se ne po i inspektojmë.

Shkumbin Demaliaj – Në seancën e ardhshme e kemi në rend dite miratimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Nuk kemi asnjë kërkesë nga MPB-ja dhe nuk dimë se çka po ndodh me buxhetin e Policisë.

Suzana Novoberdaliu – Sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Policinë, para dy takimeve, e kemi caktuar Shkumbin Demaliajn kryetar të grupit, kurse anëtarë jemi caktuar unë dhe Zafir Berisha.

Kryetari i Komisionit – Në mbledhjen e Komisionit, më 25 nëntor, e kam propozuar grupin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë, që është miratuar nga anëtarët e Komisionit.

Pasi që nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

E hartoi:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Rrustem Mustafa